

## Si të marrim informata komplementare ?

### Duke shkuar te Qyteti i zanateve dhe i formimit *Cité des métiers et de la formation*

1<sup>er</sup> étage, Espace 4. Financer sa formation Kati i parë, Hapësira 4, Financimi i formimit tim  
Rue Prévost-Martin, 6  
1205 Genève  
Pritja : 10h00 - 17h00

### Me telefon

+41 (22) 388 73 50  
9h00 - 12h00 *(përveç të enjteve)*

### Në Internet

[www.geneve.ch/bourses](http://www.geneve.ch/bourses)  
[www.citedesmetiers.ch/geneve](http://www.citedesmetiers.ch/geneve)

## Dorëzimi i kërkesave

### Me postë

SAEA  
Rue Pécolat 1  
Case postale 1603  
1211 Genève 1

*Zyrat e SAEA nuk janë të hapura për publikun*

### Me çuarje te kutia e letrave e SAEA

3<sup>ème</sup> étage  
Rue Pécolat 1  
1201 Genève

# SAEA

## Shërbimi i alokacioneve për studime dhe për stazh formimi profesional Nje ndihmë për tu formuar

- **A keni nevojë për një ndihmë financiare për të rimarrë ose ndjekur një formim mbas shkollimit të detyrueshëm ?**
- Në funksion të situatës suaj familiare, ju keni të drejtë për alokacione (Terminologjia « allocations/ alokacione » është e kantonit të Gjenezës. Ai është sinonim i termit bursë që përdoret nga kantonet e tjerë romandë) për të kryer me sukses projektin tuaj në Collège/Shkollë e mesme, në Ecole professionnelle/Shkollë profesionale, në nje Haute école spécialisée/Shkollë e lartë e specializuar (HES) ose në Universitet
- **Si ti marrim ?**

Q ë nga fillimi i vitit shkollor, ju mundeni te merrni një formular « *Demande d'aide financière pour études* » (Kërkesë për ndihmë financiare për studime) nga *Service des allocations d'études et d'apprentissage*/ Shërbimi i alokacioneve për studime dhe për stazh formimi profesional (SAEA) pranë sekretariateve ose shërbimeve sociale të institucioneve të Gjenezës de mësimdhënies mbas shkollimit të detyrueshëm : *Collège*/ Shkollë e mesme, *Ecole de culture générale*/ Shkollë e kulturës së përgjithshme (ECG), *Centres de formation professionnelle*/ Qendra të formimit profesional, *Haute école spécialisée*/ Shkollë e lartë e specializuar (HES) ose Universitet.

## Prezantimi shkurtimisht i SAEA

Përveç bursave të studimeve ose për stazh formimi SAEA, që varet nga l' *Office pour l'orientation, la formation professionnelle et continue (OFPC)*/Zyra për orientimin, formimin profesional dhe të vazhdueshëm - ofron shume mundësi për mbështetur projektet e formimit mbas shkollimit të detyrueshëm dhe më mbas.

Cdo etape te formimit i korrespondon nje formë inkurajimi e ndryshme :

- Mospagimi i taksave shkollore
- Rimbursimi i taksave të kurseve për perfeksionimin profesional, të taksave të muzikës dhe të kurseve përmbledhës / *répétitoires*
- Ceku vjetor i formimit (CAF).

Keto mbështetje financiare mund të kërkohen me anë të formularit *Demande d'aide financière pour études*/Kerkesë për ndihmë financiare për studime. Ky formular gjendet gjithashtu ne internet ose tek *Cité des métiers*/Qyteti i zanateve. Për CAF, regjistrimi bëhet ne linje në [www.geneve.ch/caf](http://www.geneve.ch/caf). Për sa i përket rimbursimit të taksave të muzikës, rimbursimit të taksave për kurse të perfeksionimit profesional ose rimbursimeve të kurseve përmbledhës/répétitoires, formularët e duhur gjenden në internet si dhe pranë institucioneve përkatës.

Prestacionet e SAEA reflektojnë investimin financiar të shtetit për çështje të inkurajimit dhe mbështetje të formimit.

## Kush mund të përfitojë nga nje bursë studimesh ose stazh formimi profesional ?

Studentë(e)t si dhe stazhierë(e)t që kanë mbaruar shkollaritetin e detyrueshëm dhe që vazhdojnë formimin

- në një institucion të mesimdhënie publike në Gjenevë
- në një institucion të mesimdhënie publike jashtë Gjenevës kur nuk ka formin ekuivalent në kanton
- në HES - shkollat e larta të specializuara - jashtë Gjenevës.

## Kush janë kushtet e marrjes ?

Ato lidhen me

- vendbanim dhe statutin fiskal de prinderve dhe të studentit/studentes ose te stazhierit/stazhieres
- situatën familiare të përgjithshme (të ardhura, pasuri, numri i fëmijëve në ngarkesë, etj.)
- ndjekjen me rregullsi të formimit.

## Shumat për bursa studimesh dhe stazh formimi profesional 2011 - 2012\*

A. Për nje stazhier ose student që ka më pak se 20 vjeç në ciklin e parë të formimit					
		Viti shkollor			
		1 <sup>e</sup>	2 <sup>e</sup>	3 <sup>e</sup>	4 <sup>e</sup>
Grupi familiar	Të ardhurat që merren parasysht				
Prindër + Fëmijë	Më pak se F.	Maksimumi F.			
2	53'850	60'183	61'608	63'033	64'458
3	61'630	67'963	69'388	70'813	72'238
4	69'410	75'743	77'168	78'593	80'018
5	77'190	83'523	84'948	86'373	87'798
6	84'970	91'303	92'728	94'153	95'578
↓		↓			
Alokacioni maksimal: 4'300 F. për vitin e parë 5'155 F. për vitin e dytë 6'010 F. për vitin e 3të 6'865 F. për vitin e 4rt		Alokacion për studime i reduktuar			

B. Për një stazhier ose student që ka më shumë se 20 vjeç ne ciklin e dytë të formimit			
		Viti shkollor/akademik	
		Viti i 1rë dhe me pak se 20 vjeç	Që nga viti i dytë ose më shume se 20 vjeç
Grupi familiar	Të ardhurat që merren parasysht		
Prindër + Fëmijë	Më pak se F.	Maksimumi F.	
2	59'230	75'563	76'997
3	67'010	83'343	84'777
4	74'790	91'123	92'557
5	82'570	98'903	100'337
6	90'350	106'683	108'117
↓		↓	
Alokacion për studime komplet		Alokacion për studime i reduktuar	
10'300 F. ose 11'160 F.			

C. Për një stazhier ose student që ka më shumë se 20 vjeç ne një cikël formimi jashtë Gjenevës		
Grupi familiar	Të ardhurat që merren parasysht	
Prindër + Fëmijë	Më pak se F.	Maksimumi F.
2	64'610	82'377
3	72'390	90'157
4	80'170	97'937
5	87'950	105'717
6	95'730	113'497
↓		↓
Alokacion për studime komplet		Alokacion për studime i reduktuar
11'160 F.		

### Të ardhurat e grupit familiar që merren parasysht përbëhen nga shumat:

- Të ardhurat bruto të personit përgjegjës dhe të bashkeshortit/bashkeshortes neqoftese nuk ka ndarje efektive,mbas zbritjes të totalit te alokacioneve familiare të marra deri në masën e caktuar nga ligji i Gjenevës mbi alokacionet familiare
- Totalit të të ardhurave bruto të fëmijëve minore në me të cilët jetojnë se bashku, të stazhierëve dhe studentëve, mbas zbritjes së shumës F. 7'780 çdo herë që familja ka fëmijë minore në që kanë mbi 15 vjeç, stazhierë dhe studentë que jetojnë bashkë me familjen.

c) 1/15 te pasurisë neto totale të personave që i takojnë grupit familiar mbas zbritjes së një shume prej F. 30'000 për person.

Alokacioni maksimal jepet kur të ardhurat a grupit familiar që merren parasysht nuk i kalojnë shumat në rubrikën «Më pak se».

Nëqoftëse të ardhurat e grupit familiar që merren parasysht ndodhen mes shumave minimale dhe maksimale të tabelave, alokacioni zvogëlohet me 60% të shumës që tejkalohet.

Alokacioni hiqet nëqoftëse të ardhurat e grupit familiar që merren parasysht i tejkalojnë shumat maksimale.